


# BULETINI



GUSHT 2024



**Në gusht, nxorrëm disa deklarata për shtyp për të adresuar çështje urgjente, për të mbrojtur drejtësinë dhe për të bërë thirrje për veprime të nevojshme për të siguruar paqen dhe transparencën në Kosovë.**

Më 8 gusht, ACDC ka lëshuar një komunikatë urgjente për media lidhur me arrestimin e dy aktivistëve të partisë “Demokracia Serbe” nga Policia e Kosovës. Deklarata kërkoi lirimin e menjëhershëm të Aleksandar Arsenijeviq dhe Stefan Veljkoviq nga partia “Srpska Demokratija”, të cilët u ndaluan padrejtësisht.

Më 31 gusht, në emër të një grupi aktivistësh të shoqërisë civile dhe organizatave joqeveritare, kemi bërë thirrje të përbashkët drejtuar KFOR-it pas veprimeve të dhunshme të Policisë së Kosovës. I bëjmë thirrje KFOR-it që urgjentisht të vendosë pika kontrolli para institucioneve që i shërbejnë popullatës shumicë në veri.

Për më tepër, OJQ ACDC, së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile nga komuniteti serb në Kosovë, kanë lëshuar deklaratën duke theksuar se nuk kanë marrë pjesë në konsultimet me kryeministrin Kurti më 16 gusht dhe kanë bërë thirrje për dialog me përfaqësuesit e komunitetit serb dhe angazhim me Beogradin nën drejtimin e BE-së. [LINK](#)

Në kuadër të koalicionit “Demokracia në Veprim”, OJQ ACDC lëshoi një deklaratë në mbështetje të vendimit për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare më 9 shkurt të vitit të ardhshëm. Organizata do të monitorojë të gjitha fazat e procesit zgjedhor me qëllim promovimin e transparencës dhe drejtësisë në procedurë zgjedhore.







Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, 12 gusht, OJQ ACDC lëshoi deklaratën dhe apeloj që të rinjve t'u jepet një hapësirë në shoqëri ku zëri i tyre dëgjohet qartë dhe zëshëm.

[LINK](#)

Më 30 gusht, OJQ ACDC lëshoi deklaratën për Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve, duke theksuar nevojën për veprime kolektive për gjetjen e të zhdukurve dhe sigurimin e drejtësisë për ta dhe familjet e tyre.

[LINK](#)

## Publikim mbi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut

Në gusht, OJQ ACDC nxorri një publikim të ri mbi Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në kuadër të fushatës #HumanRightivism në mediat sociale. Ky projekt zbatohet nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) me mbështetjen e Ambasadës Suedeze në Prishtinë. Publikimi synon të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e këtij dokumenti kyç, i cili mbetet i rëndësishëm mbi 70 vjet pas miratimit të tij, veçanërisht në shoqërinë e sotme ku të drejtat e njeriut shpesh kërcënohen.



## Njoftim për projekt të ri

Duke filluar nga shtatori, OJQ ACDC do të nisë projektin e ri të financuar nga UNMIK-u, që synon përmirësimin e qasjes në drejtësi dhe fuqizimin e gjyqësorit në Mitrovicë. Projekti do të përfshijë angazhimin e përkthyesve dhe bashkëpunëtorëve profesional në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, si dhe trajnimin e juristëve të rinj nga komunitetet joshumicë për të dhënë provimin e jurisprudencës. Gjithashtu, projekti do të mbështesë punën e Zyrës për Ndhimë Juridike në Mitrovicë.

ACDC në media

Drejtori Ekzekutiv i OJQ-së ACDC Dushan Radaković për RTS në lidhje me mbylljen e Postave Serbe në veri të Kosovës.



Aleksandar Rapajić, Drejtor i Programit në OJQ ACDC, u shfaq në podcast "Bla Bla Cafe", botuar nga CSD - Komunikimi për Zhvillim Social



Zyrtarja e programit në OJQ ACDC, Ines Aljović Mihajlović, u shfaq në "TV Prva" ku diskutoi për statusin e grave në Kosovë dhe respektimin e të drejtave të tyre në legjislacionin e Kosovës.



[www.acdc-kosovo.org](http://www.acdc-kosovo.org)

